Kronikë

Katër të mitur vjedhin një biznes në Vorë, vihen në hetim! 14-vjeçari me armë, e publikonte në rrjetet sociale

Katër të mitur të moshave 14 dhe 15 vjeç janë vënë në hetim, pasi kanë vjedhur një biznes në autostradën Tiranë-Vorë. Njëri prej tyre mbante edhe armë dhe e reklamonte në rrjetet sociale.

Arma e sekuestruar

Redaksia
11 Mars, 08:52 | **Përditesimi: 11 Mars, 09:12**

Share

TIRANË- Katër të mitur janë vënë në hetim nga policia, pasi dyshohet se janë autorë të vjedhjes së një biznesi në autostradën Tiranë-Vorë. Bëhet fjalë për katër të mitur të moshës 14 dhe 15 vjeç.

Në bashkëpunim me njëri-tjetrit, ata dyshohet se kanë vjedhur në një biznes pjesë automjetesh.

Jo vetëm kaq, por njëri prej 14-vjeçarëve mbante edhe armë zjarri. Gjatë kontrollit që uniformat blu ushtruan në banesën e 14-vjeçarit kanë gjetur dhe sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, me krehër e municion luftarak.

LEXO EDHE:
Vodhi një çek me vlerë 10 mijë euro në kompaninë ku punonte, në pranga 23-vjeçari në Tiranë

I mituri publikonte fotot të armës në rrjetet sociale.

> *"Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional mbarëkombëtar të koduar "Sundimi i ligjit", pasi kanë siguruar informacione për 4 shtetas të mitur, të cilët dyshohet se kryenin vjedhje të ndryshme, si dhe njëri prej tyre mbante në banesë, armë zjarri, dhe publikonte foto të saj në rrjete sociale, kanë organizuar punën për dokumentimin e plotë ligjor të këtyre rasteve dhe vënien e autorëve të dyshuar, përpara përgjegjësisë penale.*
>
> *Në këtë kuadër është finalizuar operacioni policor i koduar "Hand", si rezultat i të cilit u proceduan penalisht 4 të mitur, të moshave 14 dhe 15 vjeç. Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë vjedhur disa pjesë automjetesh, në një biznes, në autostradën Tiranë-Vorë. Gjatë kontrollit në banesën e njërit prej 14-vjeçarëve, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, me krehër e municion luftarak, të cilën ky shtetas e publikonte dhe në rrjete sociale", njofton policia.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Tirane vjedhje armembajtje pa leje

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kryebashkiakët e Berishës në mbledhjen e Ramës, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Një fundjavë në kryeqytetin shqiptar, në Berlinin e ri ku perceptohet tradita dhe inovacioni
10 Mars, 20:33

PS fushatë anëtarësimesh të reja edhe në njësitë rurale, Veliaj: Dera e hapur e PS do na sigurojë fitoren në zgjedhjet e ardhshme; Kur qeverisin socialistët, bëhet shtet
10 Mars, 20:14

Prindërit të alarmuar në policë! 20-vjeçarja largohet nga banesa në Tiranë, edhe e mitura i ikën nënës në Shkodër
10 Mars, 13:07

Fushata e anëtarësimeve të reja, Veliaj në terren: Dera e PS e hapur për të gjithë
10 Mars, 12:47

Të dënuar për rrëmbim, dhunë dhe shkatërrim prone, ekstradohen dy shqiptarë nga Britania dhe Gjermania
10 Mars, 11:30

FOTO+VIDEO/ Shoferit i bie të fikët në timon, aksidentohet autobusi i linjës së 'Unazës' në Tiranë
10 Mars, 10:26

'Duam fitoren për kreun', Orges Shehi: Partizani s'është i plotë
9 Mars, 21:43

Muzeu Historik për 4 vjet i mbyllur! Ministria kërkon një drejtor për të! Rikonstruksioni merr një vit më shumë kohë se ndërtimi në vitin 1981! Ja si do të financohet projekti
9 Mars, 20:48

Grushta në Kategorinë e Parë, lojtarët përplasen në korridoret e stadiumit
9 Mars, 15:37

Sollën kallashnikov nga Korça në Tiranë me autobusin e linjës, 2 të rinj arrestohen në terminal (EMRAT)

Sokol Dema

9 Mars, 14:06

Vëzhgimi i Report Tv, duhani i grirë shitet pa pullë në rrugët e Tiranës! Konsumohet nga rreth 30%, dëm shtetit deri në 80 mln euro

Freard Rista

9 Mars, 13:27

VIDEO/ Italiani humbi në Dajt, policia e gjen pas 5 orë kërkimesh
9 Mars, 10:56

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje